



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË  
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-  
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-087 për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, e konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 30.05.2024 miratoi këtë;

## V E N D I M

### Për miratimin e raportit për vitin 2023, të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A.

#### Neni 1

**MIRATOHET-** Raporti për vitin 2023 i performancës së Komisionit komunal të aksionarëve për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi në Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” SH.A. me seli në Suharekë.

#### Neni 2

Raporti i cekur në neni 1, të këtij vendimi është shqyrtuar dhe miratuar në pajtim me dispozitat e nenit 8, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmarrjet publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009.

#### Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendim është edhe raporti me numër të protokollit 01-Nr-052-25119 i datës 02.05.2024, i përgatitur nga anëtarët e Komisionit Komunal i Aksionarëve.

#### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-29986  
Me datë 30-05-2024



Kryesuesi i Kuvendit  
Mr.ec Bexhet KUÇI